



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 851/4 Prot

Tiranë, më 29/7/2020

VENDIM

Nr. 33, datë 29.7.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi Shoqëria “ORA” sh.a., përfaqësuar nga z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 851 Prot., datë 10.07.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet shkresës së datës 03.06.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

1. CV-në e z. Mariglen Qato, Kryeinspektor në Inspektoriatin Urbanistik Vendor Tiranë.
2. Dosjen e plotë dhe diplomat e arsimit që ai ka paraqitur.
3. Referencat e punësimeve të mëparshme, të dhënat e tjera të parashikuara nga ligji me të cilat plotësohet dosja e nisjes së punës.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 851 Prot., datë 10.07.2020 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 851/1 prot., datë 15.07.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në përgjigje të korrespondencës së mësipërme, koordinatoresha për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 24.07.2020, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjerat se: “*Kërkesa e subjektit është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar me nr. 118 Prot., datë 03.06.2020, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë (Drejtorisë së Arkivit Qendror dhe Protokollit) me nr. 17737 Prot., datë 03.06.2020. Në të njëjtën datë është deleguar nga Kabineti për trajtim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtorisë së Informacionit. Gjithashtu, në datën 16.07.2020 nëpërmjet e-mail-it, në cilësinë e koordinatoreshës për të drejtën e informimit ankimimi i paraqitur është përcjellë për trajtim në drejtorinë e sipërcituar...*”.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, megjithëse ka mirëkuptuar vështirësitë e hasura për shkak të problematikave të krijuara nga pandemia COVID-19 nga koordinatoresha për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, nuk përjashton në asnjë moment Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se, kërkesa e Shoqërisë “ORA” sh.a., drejtuar Autoritetit Publik, nisur nga informacioni që kërkohet, trajtohet me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim “*Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”).

Nga verifikimi i pikës 1 të kërkesës, në të cilën kërkohet “*CV-ja e z. Mariglen Qato, Kryeinspektor në Inspektoriatin Urbanistik Vendor Tiranë*”, rezulton se, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në parim kemi të bëjmë me informacion publik.

Bazuar në pikën d) të nenit 7 të ligjit të sipërcituar, çdo autoritet publik vendos në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet “*të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë...*”. Pra, një pjesë e informacionit që përmban CV-ja bën pjesë në atë kategori informacioni, i cili duhet t’i vihet në dispozicion publikut pa kërkesë.

Në këtë rast, Autoriteti Publik duhet të bëjë vlerësimin e informacionit që përmban ky dokument (*psht. adresë banimi, nr.tel etj*) dhe nëse konstatohen të dhëna personale, publikimi i të cilave do të cënonte sferën e privatësisë së tij, ai mund të vihet në dispozicion të ankuesit duke hequr pjesët që kufizohen në përputhje me pikën 6 të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e dokumentacionit të cituar më lartë pavarësisht se ai nuk është i prodhuar nga Autoriteti Publik por administrohet nga ai, ngarkon me përgjegjësi, këtë të fundit për koordinimin midis drejtorive dhe ngarkimin e personave përgjegjës, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Në lidhje me pikën 2 në të cilën kërkohet “*Dosja e plotë dhe diplomat e arsimit që z. Qato ka paraqitur*” si dhe pikën 3 “*Referencat e punësimeve të mëparshme, të dhënat e tjera të parashikuara nga ligji me të cilat plotësohet dosja e nisjes së punës*”, Komisioneri, në referim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson se kemi të bëjmë me të dhëna personale.

Sqarojmë se, në parim, e drejta e aksesit në të dhëna personale, sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale. Kërkesa e paraqitur në rastin konkret bazohet në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, ku një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private.

Në këtë rast, duke qenë se bëhet fjalë për një funksionar publik (*Kryeinspektorin e Inspektoriatit Urbanistik Vendor Tiranë*), ekziston një përjashtim referuar shkronjës b) të pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se “*Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre*”.

Gjithsesi, ky parashikim zbatohet në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave të parashikuar në nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në këtë kuptim, përhapja e informacionit kufizohet lidhur me aksesimin e dokumenteve të dosjes personale të subjektit të të dhënave (dosja e plotë dhe diplomat e arsimit), që përmbajnë të dhëna personale të lidhura ngushtësisht me individin dhe si të tilla, nuk mund të vihen në dispozicion pa pëlqimin paraprak të tij.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Shoqërisë “ORA” sh.a., ndaj Autoritetit Publik/Bashkia Tiranë, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankesa duhet pranuar në mënyrë të pjesshme.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Autoriteti Publik në bërjen publike të dokumentit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*".

Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, njësisive të qeverisjes vendore i'u lind gjithashtu edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.

Konkretisht në nenin 15 të ligjit të sipërcituar "Transparenca e veprimtarisë së njësisive të vetëqeverisjes vendore", parashikohet se: "*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. 2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...*".

Bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", "*autoriteti publik trajton kërkesën për informim brenda 10 ditëve pune nga data e dorëzimit të saj*". Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 parashikohet se *mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative*. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se *veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë veprë penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë personat përgjegjës*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 851 Prot., datë 10.07.2020 të Shoqërisë “ORA” sh.a., përfaqësuar nga z. _____, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën 1 (CV-në e z. Mariglen Qato, Kryeinspektor në Inspektoriatin Urbanistik Vendor Tiranë.) të kërkesës për informacion datë 03.06.2020, brenda datës 06. 8 .2020.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikat 2 dhe 3 (Dosjen e plotë dhe diplomat e arsimit që ai ka paraqitur. Referencat e punësimeve të mëparshme, të dhënat e tjera të parashikuara nga ligji me të cilat plotësohet dosja e nisjes së punës.) të kërkesës për informacion datë 03.06.2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 29. 7 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Besnik Dervishi". To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQËRISË" at the top, "KOMISIONI I DREJTËSË MËDITARE" in the center, and "IDP" at the bottom. The stamp also features a small emblem in the center.